



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE

VENDIM

Nr. 11, dt. 06.08.2007

Per miratim te Kontrates Tip, te Koncesionit, ndermjet autoriteteve te ujit (A.U.B-se "Vjose") dhe Sh.A Ujesjelles Kanalizime, Sarande, per perdorimin me koncesion te burimit uxor "Navaric".

Ne zbatim te kerkesave te Ligjit Nr.8093, dt. 21.03.1996, "Per rezervat ujore", te specifikuara ne nenet 9, 10, 11, 12, 14 dhe 16, si dhe Vendimit Nr.2, Dt. 03.03.2005 te K.K.U-se, "Per miratimin e Kontrates Tip te Koncesionit, ndermjet autoriteteve te ujit dhe Sh.A Ujesjelles-Kanalizimeve, per perdorimin me koncesion te ujit", kontrate e cila eshte nenshkruar sipas kerkesave te ligjit ndermjet A.U.B-se "Vjose" dhe Sh.A Ujesjelles Kanalizime, Sarande, per perdorimin me koncesion te burimit uxor "Navarice", me prurje 20 l/sek, A.U.B "Vjose":

VENDOSI:

1. Miratimin e Kontrates Tip te Koncesionit, lidhur ndermjet A.U.B-se "Vjose" dhe Sh.A Ujesjelles Kanalizime, Sarande, per perdorimin me koncesion te burimit uxor "Navaric", me $Q = 20$ l/sek.
2. Afati i perdorimit do te jete 30 vjet.
3. Ngarkohet A.U.B "Vjose", per zbatimin e ketij vendimi.
4. Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.U.B-se "VJOSE"

Vezi METAJ



KRYETARE E K.B.U-se

Dorothe KONOMI

